



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 277, Datë 10.12.2019

PËR

**MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR GJYQTAREN E GJYKATËS
SË RRETHIT GJYQËSOR {...}, {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikën 3, të nenit 65, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit mbi motivin bazuar mbi shkaqe shëndetësore, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 17.12.2019.
3. Përrjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarës {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.
4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR